



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut  
Opština Kačanik  
Municipal Kačanik

01Nr. 03-60/01-6551/24  
Kaçanik, 29.03.2024

Në mbështetje të nenit 45.1 dhe 2 të Ligjit Nr. 04/L-125 për Shëndetësi (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 13/ 07 Maj 2013), të Neni 11, 12.2(d) të Ligji Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/04 Qershor 2008), të Udhëzimit Administrativ 04/2020 Kujdesi Parësor Shëndetësor, të nenit 6.1 të Statutit të komunës së Kaçanikut (Teksti i spastruar sipas statutit 01Nr.60/01-12895/20 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Statutit të Komunës së Kaçanikut 01Nr.3588/2008 të datës 25.09.2008), Kuvendi i Komunës Kaçanik, në mbledhjen e mbajtur me datë 29 mars 2024, mori këtë:

**VENDIM**  
**PËR APROVIMIN E STATUTIT TË QENDRËS KRYESORE**  
**TË MJEKËSISË FAMILJARE NË KAÇANIK**

1. Me këtë Vendim, MIRATOHET Statuti i Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare (QKMF) në Kaçanik.
2. Statuti i QKMF nga pika 1. e këtij vendimi, ka numër të protokollit 01Nr.03-60/01-6551/24, përmban gjithsej 30 nene dhe i njëjti është pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset: Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.
4. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës- MAPL, si dhe 7 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të komunës.

Me këtë Vendim njoftohen:

1. Kryetari i Komunës;
2. Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale (përmes kësaj drejtorie njoftohen mekanizmat tjerë relevantë);
3. Arkivi.



Kryesuesi i Kuvendit  
Kemal Murseli